



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE**  
**KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE**

05.10.2024

*“Procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit”*

**ALTERNATIVA (18 x 1 pikë)**

**1. Cila nga vijueset nuk është e vërtetë për kompetencat e organizatës profesionale të audituesve ligjorë?**

- a) Harton dhe miraton rregullat për praktikën profesionale dhe kualifikimin e vijueshëm
- b) Harton kurrikulat për programin e përgatitjes dhe trajnimeve profesionale për kandidatët që kërkojnë të hyjnë në profesion
- c) Harton dhe miraton rregullat e praktikës profesionale ku parashikohen hollësi për komisionin e stazhit, hyrjen në praktikën profesionale, kualifikimin, ndjekjen, raportimin, kontrollin, testimin paraprak, raportimet periodike, si dhe drejtuesit e praktikës profesionale
- d) Mbikqyr dhe kontrollon cilësinë për auditimet e njëjësive me interes publik
- e) Mban dhe përditëson regjistrin publik të audituesve ligjorë audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese;

Përgjigja e saktë është alternativa D

**2. Cilat nga sa me poshte mund te jene shembuj veprimesh nga nje profesionit kontabel për të adresuar kërcënimet e krijuara nga një konflikt interesi?**

- a) Ekipë të ndara të cilëve u sigurohen politika të qarta dhe procedurat për ruajtjen e konfidencialitetit;
- b) Rishikues i përshtatshëm, i cili nuk është i përfshirë në ofrimin e shërbimit për të vlerësuar nëse gjykimet kryesore dhe konkluzionet janë të përshtatshme;
- c) Veprime të tjera që përcaktohen nga profesionisti kontabel;
- d) A dhe B me lart;
- e) Asnjë nga alternativat e mësipërme

Përgjigja e saktë është alternativa C

**3. Cila është e vërtetë për kushtet që duhet të përmbushë një kandidat për t'u regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë?**

- a) Të ketë përfunduar studimet universitare të ciklit të parë
- b) Të ketë kryer të paktën gjysmën e praktikës profesionale për 3 vite
- c) Të ketë përvojë pune për 10 vite në një profesion tjetër
- d) Të ketë kaluar të gjitha testet e parashikuara në programin e përgatitjes profesionale
- e) A dhe C me lart.

Përgjigja e saktë është alternativa D

**4. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese publikon në faqen zyrtare të internetit një raport për transparencën kur:**

- a) Eshte subjekti i kontrollit te cilesise nga Organizata Profesionale;
- b) Eshte subjekti i kontrollit te cilesise nga Bordi i Mbikqyrjes Publike;
- c) Kryen auditimin ligjor të njësive ekonomike me interes publik;
- d) Kryen auditimin ligjor të degeve te shoqerive te listuara;
- e) Të gjitha më sipër

Përgjigja e saktë është alternativa C

**5. “Njësi ekonomike me interes publik” për efekt të identifikimit të bazës kontabël mbi të cilën janë përgatitur pasqyrat financiare që do të auditohen janë:**

- a) Të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë
- b) Bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë
- c) Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar
- d) Shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave
- e) Të gjitha më sipër

Përgjigja e saktë është alternativa E

**6. Çfarë duhet të ndodhë nëse një auditues ligjor ose një shoqëri audituese zëvendësohet para se të përfundojë angazhimi i auditimit sipas kuadrit ligjor të auditimit?**

- a) Audituesi i zëvendësuar ose shoqëria audituese duhet të shkatërrojë të gjitha evidencat lidhur me auditimin
- b) Audituesi i zëvendësuar ose shoqëria audituese duhet të sigurojë që të gjitha dokumentet lidhur me auditimin të transferohen te audituesit pasues
- c) Audituesi i zëvendësuar ose shoqëria audituese nuk ka nevojë të ofrojë asnjë dokumentacion tek audituesi pasues
- d) Audituesi i zëvendësuar ose shoqëria audituese duhet të informojë autoritetet përkatëse, por nuk është e nevojshme të transferojë ndonjë dokumentacion
- e) A dhe C me siper

Përgjigja e saktë është alternativa B

**7. Cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e cilësisë së auditimit sipas SNA 220?**

- a) Vetëm drejtori i auditimit.
- b) Çdo anëtar i ekipit të auditimit.
- c) Partneri përgjegjës për auditimin.
- d) Menaxheri financiar i kompanisë që auditohet.
- e) Komiteti i auditimit.

Përgjigja e saktë është alternativa C

**8. Çfarë do të kuptojmë me termin "siguri e arsyeshme" në kontekstin e një auditimi të pasqyrave financiare?**

- a) Siguri absolute që pasqyrat financiare janë pa gabime
- b) Një nivel i lartë, por jo absolut, i sigurisë që nuk ka anomali materiale
- c) Një garanci që pozicioni financiar i kompanisë është i saktë
- d) Një rishikim i të gjitha transaksioneve
- e) Auditimi do të zbulojë të gjitha rastet e mashtrimit

Përgjigja e saktë është alternativa B

**9. Çfarë duhet të bëjë audituesi nëse, gjatë auditimit, gjen gabime që tejkalojnë nivelin e materialitetit të vendosur sipas SNA 320?**

- a) Të mbyllë auditimin menjëherë;
- b) Të informojë menaxhimin për gabimet dhe të kërkojë korigjimin e tyre;
- c) Të ndryshojë nivelin e materialitetit pa rishikim të mëtejshëm;

- d) Të raportojë gabimet tek autoritetet ligjore;
- e) Të injorojë gabimet pasi ato janë materiale për pasqyrat financiare;

Përgjigja e saktë është alternativa B

**10. Sipas SNA 240, cili nga faktorët e mëposhtëm është një tregues i mundshëm i mashtrimit që audituesi duhet të marrë parasysh?**

- a) Rritja e numrit të shitjeve dhe të ardhurave të shoqërisë
- b) Një sistem i qartë dhe i mirë-organizuar i kontrollit të brendshëm
- c) Presioni i madh i Drejtuesve për të arritur objektivat e performancës financiare
- d) Ndryshimet pozitive në strukturën e kapitalit të shoqërisë
- e) Bashkëpunimi i ngushtë i drejtimit të shoqërisë me audituesin

Përgjigja e saktë është alternativa C

**11. Cili nga këto burime të evidencës së auditimit konsiderohet më pak i besueshëm?**

- a) Deklaratat e palëve të treta;
- b) Inspektimi i dokumenteve origjinale;
- c) Konfirmimet bankare të jashtme;
- d) Raportet e brendshme të gjeneruara nga Shoqëria;
- e) Te gjitha me lart.

Përgjigja e saktë është alternativa D

**12. Cilat janë përgjegjësitë e audituesit sipas ISA 250 lidhur me ligjet dhe rregulloret?**

- a) Të sigurohet që kompania ka ndjekur të gjitha ligjet.
- b) Të japë një opinion ligjor mbi çdo shkelje ligjore.
- c) Të identifikojë papajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret që mund të ndikojnë në pasqyrat financiare.
- d) Të kryejë procedura ligjore për të mbrojtur kompaninë nga gjykatat ligjore.
- e) Të sigurohet që ligjet tatimore janë ndjekur në mënyrë të rreptë.

Përgjigja e saktë është alternativa C

**13. Si duhet nje auditues të trajtojë gabimet që nuk janë materiale individualisht, por që mund të jenë materiale në total, sipas SNA 450?**

- a) Të injorojë gabimet që nuk janë materiale individualisht
- b) Të përfshijë gabimet në një raport të veçantë që nuk ndikon në opinionin e auditimit
- c) Të sigurohet që të gjitha gabimet të korrigjohen para lëshimit të raportit përfundimtar
- d) Të vlerësojë ndikimin e kombinuar të gabimeve për të përcaktuar nëse janë materiale
- e) Të raportojë vetëm gabimet e mëdha dhe të lërë gabimet e vogla për rishikim të brendshëm

Përgjigja e saktë është alternativa D

**14. Çfarë përfshihet në një opinionin të pa modifikuar?**

- a) Konfirmim për gabime materiale pa ndikim në vendimmarrje;
- b) Deklaratë për pajtueshmëri me standardet dhe prezantim të drejtë të pasqyrave financiare;
- c) Përmbledhje e ndryshimeve të rëndësishme në standardet kontabël;
- d) Konfirmim për mungesë devijimi material, pavarësisht metodave;
- e) A dhe D me lart

Përgjigja e saktë është alternativa B

**15. Sipas SNA 700 data e raportit të audituesit informon përdoruesin e këtij raporti që audituesi**

- a) Ka marre në konsideratë vetem ngjarje qe jane reflektuar deri ne date e mbylljes se ushtrimit kontabel;
- b) Nuk ka pergjegjesi per periudhen mbas dates se firmosjes te pasqyrave financiare nga Drejtimi i Entitetit;
- c) Ka marrë në konsideratë efektin e ngjarjeve dhe transaksioneve, për të cilat audituesi është vënë në dijeni dhe që kanë ndodhur deri në datën e raportit;
- d) Asnje nga alternativat e mësipërme;
- e) Të gjithë alternativat e mësipërme.

Përgjigja e saktë është alternativa C

**16. Përgjegjësia e Auditorit Ligjor për vlerësimin e aftësisë së Entitetit për të vazhduar në vijimësi kërkon qe?**

- a) Te marri në konsideratë faktin nëse ekzistojnë ngjarje apo kushte që hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi;
- b) Te çmoje vlerësimin e drejtimit për aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi;

- c) Te pyesi drejtuesit per ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi;
- d) Te marri evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të përcaktuar nëse ekziston apo jo ndonjë pasiguri materiale per aftësisë së Entitetit për të vazhduar në vijimësi;
- e) Të gjitha alternativat e mësipërme.

Përgjigja e saktë është alternativa E

**17. Cila alternative nuk është e sakte?**

- a) Audituesi i entitetit, i cili është i angazhuar për të kryer një rishikim të informacionit financiar të periudhave të ndërmjetme duhet të kryejë rishikimin në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Angazhimeve të Rishikimit 2410 .
- b) Profesionisti i praktikës që kryen rishikimin në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Angazhimeve të Rishikimit 2410 nuk është auditues i entitetit.
- c) Në një angazhim të sigurisë së kufizuar, profesionisti i praktikës zvogëlon rrezikun e angazhimit në një nivel të pranueshëm për rrethanat e angazhimit, por ky rrezik është më i lartë se në rastin e një angazhimi të sigurisë së arsyeshme
- d) Të gjithë alternativat e mësipërme
- e) A dhe B me lart

Përgjigja e saktë është alternativa B

**18. Nese nje profesionisti kontabël mund t'i kërkohet të japë një opinion rishikimi dytësor cilat do te ishin disa nga veprimet që mund të shërbejnë si masa mbrojtëse për adresimin e kërcënimit ndaj kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur.**

- a) Marrjen e informacionit, me lejen e klientit, nga profesionisti kontabël ekzistues ose paraardhës;
- b) Përshkrimin e kufizimeve që rrethojnë ndonjë opinion në komunikimet me klientin;
- c) Dhënien e një kopjeje të opinionit për profesionistin kontabël ekzistues ose paraardhë;
- d) Refuzimin e angazhimit;
- e) Asnje nga alternativat e mesiperme;

Përgjigja e saktë është alternativa A,B,C

## **PYETJE ME SHITJELLIM (4 pikë secila pyetje)**

**Pyetje 1:** Cilat janë të paktën 4 rastet në të cilat një shoqëri audituese hiqet përfundimisht nga regjistri publik i audituesve ligjorë?

### **Përgjigje:**

Audituesi ligjor fshihet përfundimisht nga regjistri publik i audituesve ligjorë në rastet kur:

1) heq dorë nga e drejta për ushtrimin e profesionit. Heqja dorë bëhet nëpërmjet deklaramit me shkrim, kopje të të cilit i dërgohen organizatës profesionale dhe bordit të mbikëqyrjes publike;

2) konstatohen parregullsi në:

- i. dokumentet e nevojshme, të lidhura me provimet e aftësisë profesionale;
- ii. deklaramet, të cilat rezultojnë të pavërteta, në lidhje me dhënien fund të papajtueshmërive, që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale, të dorëzuara në çastin e bërjes së kërkesës për regjistrimin e parë në regjistrin publik;
- iii. dokumentet e në faktet e deklaruara gjatë procedurave të mundshme të pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit;

3) në përfundim të një procedure disiplinore ndaj tij, është marrë masa disiplinore e çregjistrimit nga regjistri publik;

4) është hequr e drejta e ushtrimit të profesionit, për shkak të ndryshimit të kushteve të domosdoshme për regjistrim, të lidhura me pjesëmarrjen në kapital;

5) për shkak të shkeljeve dhe masave disiplinore të përsëritura, reputacioni i të regjistruarit është cenuar ndjeshëm;

dh) në përputhje me dispozitat e këtij ligji, bordi ka vendosur çregjistrimin nga regjistri publik;

6) individi i regjistruar në regjistrin e audituesve ligjorë arrin moshën 65 vjeç, me 20 përjashtim të audituesve ligjorë me titull shkencor “Doktor i shkencave” apo me titull më të lartë, të cilët çregjistrohen kur arrijnë moshën 68 vjeç;

7) vdes.

**Pyetje 2:** Shtjelloni se çfare komunikimesh duhet kryeje nje profesionist kontabel kur tarifat gjithsej nga një klient auditimi që është një entitet me interes publik përfaqësojnë, ose ka të ngjarë të përfaqësojnë, më shumë se 15% të tarifave gjithsej të marra nga firma audituese.

### **Përgjigje:**

Kur Varësia nga honorari (tarifa) nga një klient auditimi që është një entitet me interes publik përfaqësojnë, ose ka të ngjarë të përfaqësojnë çdo vit për tre vitet financiare të fundit të njëpasnjëshme, më shumë se 15%

të tarifave gjithsej të marra nga firma, firma duhet ti komunikojë personave të ngarkuar me qeverisjen të klientit të auditimit:

- (a) Këtë fakt dhe faktin nëse kjo situatë ka të ngjarë të vazhdojë;
- (b) Masat mbrojtëse të aplikuara për të adresuar kërcënimet e krijuara, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme;
- (c) Përdorimin e një rishikimi para lëshimit të raportit; dhe
- (d) Cdo propozim për të vazhduar si auditues;

**Pyetje 3:** Diskutoni ndikimin e ofrimit të shërbimeve të jo-auditimit nga i njëjti auditues që kryen auditimin në pavarësinë dhe objektivitetin e auditimit. Cilat janë disa nga masat mbrojtëse që mund të merren për të menaxhuar këto rreziqe?

### **Përgjigje:**

Ligji dhe vete Kodi i Etikës së IEKA apo IESBA thekson rëndësinë e pavarësisë dhe objektivitetit të audituesit në çdo angazhim të auditimit. Ofrimi i shërbimeve të jo-auditimit nga audituesi që kryen auditimin mund të shkaktojë kërcënime të pavarësisë, të cilat çënojnë cilësinë dhe objektivitetin e punës së audituesit, siç janë:

1. Kërcënimi i vetë-rishikimit - Kur audituesi shqyrton punën e vet në lidhje me një shërbim jo-auditimi, rritet rreziku që ai të mos jetë objektiv në vlerësimin e rezultateve.
2. Kërcënimi i përfshirjes (advocacy) - Ofrimi i këshillave të menaxhimit mund të çojë në përfshirjen e audituesit në vendime që duhet të jenë ekskluzivisht të menaxhimit, duke minuar pavarësinë.
3. Kërcënimi i interesit personal - Marrja e tarifave të konsiderueshme nga shërbimet jo-audituese mund të krijojë varësi financiare nga klienti, duke rrezikuar objektivitetin e audituesit.

### **Masat për Menaxhimin e Këtyre Rreziqeve**

1. Kufizimi i Shërbimeve të Jo-Auditimit - Në disa rrethana, audituesi nuk duhet të ofrojë shërbime që mund të ndikojnë pavarësinë, veçanërisht kur ato përfshijnë vendimmarrjen për klientin.
2. Rotacioni i Partnerëve - Rotacioni i partnerëve të angazhuar në auditim në intervale të caktuara kohore për të shmangur ndërtimin e marrëdhënieve të afërta që mund të ndikojnë pavarësinë.
3. Rishikimi nga Palët e Treta - Përdorimi i një palë të tretë të pavarur për të rishikuar punën dhe për të siguruar që pavarësia nuk është çënuar.
4. Deklaratat e Pavarësisë - Audituesit duhet të deklarojnë rregullisht pavarësinë e tyre në marrëdhënie me klientin për të siguruar transparencë.
5. Cmime minimale të paracaktuara për shërbimet e joauditimit
6. Ndarja e ekipeve
7. Trajnime të rregullta dhe të vazhdueshme mbi etikën profesionale dhe pavarësinë bazuar në politika të miratuara dhe përditësuara cdo vit.



**Pyetje 4:** Diskutoni konceptin e materialitetit sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA 320). Si ndikon vlerësimi i materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi? Përmendni dy aspekte kryesore që audituesi duhet të marrin parasysh kur vendosin nivelin e materialitetit.

### Përgjigje:

#### 1. Diskutoni konceptin e materialitetit sipas SNA 320.

Materialiteti është një koncept themelor në auditim dhe përgjegjësi e audituesit për tu zbatuar në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare. Në kontekstin e auditimit koncepti i materialitetit kryesisht ka të bëjë me:

- Anomalitë, përfshirë mungesat, konsiderohen materiale nëse pritet që ato, individualisht ose së bashku, të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare.
- Gjykimet mbi materialitetin bëhen në bazë të rrethanave përkatëse dhe ndikohen nga madhësia, natyra e anomalive, ose kombinimi i të dyjave.
- Këto gjykime bazohen në nevojat e përbashkëta të përdoruesve të informacionit financiar si një grup, pa marrë parasysh nevojat e veçanta të përdoruesve individualë.

Përcaktimi i materialitetit nga audituesi është një çështje e gjykimit profesional dhe ndikohet nga perceptimi i audituesit i nevojave për informacion financiar të përdoruesve të pasqyrave financiare duke supozuar që përdoruesit:

- a) Kanë njohuri të arsyeshme të biznesit, aktiviteteve ekonomike dhe kontabilitetit dhe janë të gatshëm për të studiuar informacionin në pasqyrat financiare me kujdes të arsyeshëm;
- b) Kuptojnë se pasqyrat financiare janë përgatitur, paraqitur dhe audituar në nivelet e materialitetit;
- c) Njohin pasiguritë e vetvetishme në matjen e shumave bazuar në përdorimin e vlerësimeve, gjykimit dhe në parashikimin e ngjarjeve të ardhshme; dhe
- d) Marrin vendime të arsyeshme ekonomike në bazë të informacionit në pasqyrat financiare.

#### 2. Vlerësimi i materialitetit ndikon në mënyrën e planifikimit të auditimit duke ndihmuar audituesin të përcaktojë fushat ku duhet të përqendrojë punën dhe burimet e tij.

##### Planifikimi i auditimit:

Audituesi përcakton një nivel materialiteti që do ta ndihmojë të përqendrohet në ato aspekte të pasqyrave financiare që kanë më shumë gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm në vendimet e marra nga përdoruesit e pasqyrave. Ky vlerësim ndihmon në identifikimin e fushave me rrezik më të lartë për anomali materiale, dhe kështu përcakton se cilat procedura dhe teste duhet të kryhen. Një nivel i lartë materialiteti mund të kërkojë më pak kontrolle, ndërsa një nivel më i ulët do të kërkojë një mbulim më të gjerë të transaksioneve dhe balancave.

##### Kryerja e auditimit:

Gjatë auditimit, audituesi përdor nivelin e materialitetit për të vlerësuar nëse pasqyrat financiare, si një e tërë, janë të lira nga anomali materiale. Ai ndikon në përcaktimin e sasisë së evidencës që duhet mbledhur dhe të testimeve që duhet kryer. Gjithashtu, auditori vlerëson nëse anomalitë e gjetura gjatë auditimit janë nën pragun e materialitetit ose nëse janë mjaftueshëm të rëndësishme për të kërkuar korrigjime.

3. Dy aspekte kryesore që auditorët duhet të marrin parasysh kur vendosin nivelin e materialitetit janë:
  - **Madhësia, natyra e subjektit ose transaksioneve:** Audituesit duhet të shqyrtojnë se si funksionon kompania, strukturën e saj financiare dhe sektorin në të cilin operon. Natyra e aktiviteteve të kompanisë do të ndihmojë në përcaktimin një niveli të materialitetit që është i përshtatshëm për të.
  - **Ndikimi i anomalive të mundshme:** Audituesit duhet të vlerësojnë se si anomalitë e mundshme në informacionin financiar mund të ndikojnë në vendimet marrjen e përdoruesve të këtij informacioni. Ky vlerësim ndihmon në përcaktimin e një niveli të materialitetit që është i përshtatshëm për të adresuar këto pasaktësi. Në këtë aspekt, përveç madhësisë, natyra e informacionit është gjithashtu e rëndësishme. Disa lloj anomalish, pavarësisht vlerës së tyre monetare, mund të jenë materialisht të rëndësishme për shkak të natyrës së tyre (p.sh., shkeljet ligjore).

Përmes vlerësimit të materialitetit, audituesi mund të sigurojnë që auditimi i kryer të jetë i efektshëm dhe që informacioni financiar të jetë i besueshëm për përdoruesit e tij.

**Pyetje 5:** Shpjegoni termin “rreziku i auditimit” dhe tre elementët e rrezikut që kontribuojnë në rrezikun total të auditimit.

**Përgjigje:**

Termi “rreziku i auditimit” i referohet rrezikut që audituesi të shprehë një opinion auditimi të papërshtatshëm, kur në të vërtetë pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale. Rreziku i auditimit është një funksion i rrezikut të anomalisë materiale dhe rrezikut të moszbulimit.

Rreziku i auditimit përbëhet nga tre elementë kryesorë:

1. **Rreziku i vetvetishëm:** Dyshimi që një pohim për një klasë të transaksionit, tepriçës së llogarisë, ose për një informacion shpjegues të dhënë, mund të përmbajë një anomali, e cila mund të jetë materiale individualisht, ose edhe kur ajo bashkohet me anomali të tjera, duke supozuar që asnjë nga kontrollet e brendshme nuk ka funksionuar.
2. **Rreziku i kontrollit:** Ky është Rreziku që një pohim për një klasë të transaksionit, tepriçës së llogarisë, ose për një informacion shpjegues të dhënë, mund të përmbajë një anomali, e cila mund të jetë materiale si individualisht, ashtu edhe kur ajo bashkohet me anomali të tjera, dhe që nuk do të mund të parandalohet ose zbulohet dhe korrigjohet në kohë nga kontrolli i brendshëm i entitetit.
3. **Rreziku i moszbulimit:** Ky është rreziku që procedurat e kryera nga audituesi për të zvogëluar rrezikun e auditimit në një nivel të ulët të pranueshëm, nuk do të arrijnë të zbulojnë një anomali që ekziston dhe që mund të jetë materiale qoftë e vetme, ashtu edhe kur ajo bashkohet me anomali të tjera.

Të tre këta elementë së bashku kontribuojnë në rrezikun total të auditimit.

**Pyetje 6:** Gjatë hartimit të strategjisë së përgjithshme të auditimit, audituesi duhet të marrë parasysh disa elemente kyçe. Përshtatshëm nga hapat kryesorë që audituesi duhet të ndjekë sipas kërkesave të SNA-ve për hartimin e kësaj strategjie.

### **Përgjigje:**

Në përgjigjen e saktë katër nga pesë pikat e mëposhtme janë te mjaftueshme për të marrë pikët maksimale

1. **Identifikimi i karakteristikave të angazhimit:** Audituesi duhet të identifikojë karakteristikat specifike të angazhimit që përcaktojnë objektin dhe qëllimin e tij. Këto karakteristika mund të përfshijnë natyrën e entitetit, industrinë në të cilën vepron, si dhe transaksionet apo aktivitetet kryesore të entitetit.
2. **Përcaktimi i objektivave të raportimit dhe natyrës së komunikimeve:** Audituesi duhet të përcaktojë objektivat e raportimit të angazhimit për të planifikuar afatin e auditimit. Kjo përfshin gjithashtu përcaktimin e natyrës dhe frekuencës së komunikimeve që janë të nevojshme midis auditorit dhe palëve të interesuara gjatë procesit të auditimit.
3. **Konsiderimi i faktorëve të rëndësishëm për grupin e angazhimit:** Në gjykimin profesional të tij, audituesi duhet të marrë në konsideratë faktorët që janë të rëndësishëm për drejtimin dhe përqendrimin e përpjekjeve të grupit të angazhimit. Këta faktorë mund të përfshijnë rreziqet kryesore, komplekset e operacioneve, ose aspekte të tjera që ndikojnë në qasjen e auditimit. (1 pikë)
4. **Vlerësimi i aktiviteteve paraprake dhe përshtatshmëria e njohurive nga angazhimet e tjera:** Audituesi duhet të vlerësojë rezultatet e aktiviteteve paraprake të angazhimit. Nëse është e zbatueshme, ai duhet të shqyrtojë nëse njohuritë e fituara nga angazhime të tjera, të kryera nga ortaku i angazhimit, janë të përshtatshme dhe të dobishme për entitetin aktual që po auditohet.
5. **Përcaktimi i natyrës, kohës dhe burimeve të nevojshme për angazhimin:** Audituesi duhet të përcaktojë natyrën, afatin dhe shtrirjen e burimeve të nevojshme për kryerjen e auditimit. Kjo përfshin planifikimin e numrit të njerëzve, ekspertizës së kërkuar dhe mjeteve që do të përdoren për të përmbushur angazhimin në mënyrë efektive dhe efikase.

**Pyetje 7:** Si do të interpretohej një rezultat nga testimet thelbësore që do të rezultonin në kualifikimin e opinionit të auditimit, gjatë testimit të inventarit në një shoqëri prodhimi.

### **Përgjigje:**

Një opinion i kualifikuar jepet nga audituesi kur ai arrin në përfundimin se pasqyrat financiare të shoqërisë janë të përgatitura në përputhje me standardet përkatëse, me përjashtim të një gabimi material që është i pranishëm, por që nuk është i përhapur dhe nuk ndikon në tërësinë e pasqyrave financiare. Në rastin e inventarit të një shoqërie prodhimi, interpretimi i një rezultati që çon në një opinion të kualifikuar mund të përfshijë:

- Gabimin material: Vlera e inventarit që pasqyrohet në pasqyrat financiare ka një gabim material, i cili vlerësohet të jetë me i lartë se niveli i materialitetit të përlogaritur nga audituesi. Ky gabim është i rëndësishëm në aspektin e vlerës, por nuk është aq i madh sa të ndikojë të gjithë pasqyrat financiare në tërësi. Ky mund të jetë një mbivlerësim/nënvlerësim i vlerës së inventarit dhe/ose i kostove të shitjes. Ky gabim është i izoluar në zërat e lidhur me inventarin në pasqyrën e pozicionit

kontabël dhe atë të të ardhurave dhe shpenzimeve.

- Përhapje e kufizuar: Gabimi në vlerën e inventarit mund të jetë e izoluar vetëm për disa zëra të inventarit dhe jo për të gjithë popullatën.
- Pamundësi për të matur saktësisht gabimin: Audituesi nuk ka qenë në gjendje të përcaktojë saktësisht ndikimin material të gabimit. Kjo mund të ndodhë për shkak të mungesës së dokumentacionit të mjaftueshëm ose vështirësive në vlerësimin e saktë të gjendjes së inventarit.
- Pamje e përgjithshme: Me përjashtim të këtij gabimi, pasqyrat financiare në tërësi japin një pamje të drejtë dhe të vertetë të pozicionit kontabël, fitim humbjes së periudhës, flukseve monetare dhe lëvizjeve në kapitalin neto. Kjo nënkupton që, megjithëse ka një gabim në një pjesë të caktuar të inventarit, pjesa tjetër e informacionit financiar është e besueshme dhe përputhet me standardet e raportimit.

**Pyetje 8:** Përshkruani procedurat që shërbejnë për mbledhjen e evidencave të auditimit sipas SNA 500.

### **Përgjigje:**

Për të mbledhur evidencat e auditimit sipas SNA 500, audituesi përdor dy teste kryesore: Testet e Kontrollit dhe Testet Thelbesore. Të dyja ndihmojnë në sigurimin e evidencave të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të arritur në një përfundim mbi pasqyrat financiare.

#### **1. Testet e Kontrollit**

Këto teste përdoren për të vlerësuar praninë dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme të subjektit për ato procese të lidhura me raportimin financiar. Procedurat për mbledhjen e evidencave mund të përfshijnë si më poshtë:

- Vëzhgimi: Audituesi vëzhgon proceset e punës për të siguruar që kontrollet ekzistojnë, kuptohen nga personeli përgjegjës dhe funksionojnë në mënyrë efektive.
- Rishikimi i Dokumenteve: Audituesi shqyrton dokumente si regjistrat e kontrollit të brendshëm për të parë nëse kontrollet janë aplikuar sipas procedurave në fuqi. Rishikimi i referohet dhe rishikimit të procedurave dhe politikave që udhëheqin proceset e punës.
- Rillogaritja: Ushtrohet për të verifikuar saktësinë e zbatimit të kontrolleve, për shembull në procese rakordimi të shitjeve, furnitorëve, lëvizjeve të llogarive bankare.
- Rikryerja: Audituesi mund të rikryejë kontrollin në mënyrë të pavarur nga shoqëria që të mund të

vlerësojë nëse ky kontroll është efektiv dhe adreson rreziqet e vlerësuara.

## **2. Testet Thelbesore**

Këto teste përdoren për të vlerësuar saktësinë dhe plotësinë e transaksioneve. Procedurat kryesore përfshijnë:

- Rishikimi i Dokumentacionit: Verifikimi i dokumentacionit mbështetës për transaksionet financiare, si faturat, kontratat dhe raportet e tjera, për të konfirmuar saktësinë dhe vlefshmërinë e tyre.
- Konfirmimet: Marrja e konfirmimeve nga palë të treta (p.sh., furnitorë, banka) për të siguruar që të dhënat e regjistruara nga subjekti janë të sakta.
- Procedurat Analitike: Krahasimi i të dhënave financiare ndër vite ose analiza e raporteve financiare për të identifikuar devijime ose anomali të mundshme.
- Rillogaritja: Kryerja e përlogaritjeve të pavarura për të konfirmuar saktësinë e shifrave të paraqitura në pasqyrat financiare.

**Pyetje 9:** Cili është fushëveprimi i Standardit Ndërkombëtar të Angazhimeve të Rishikimit (SNAR) 2400? Nga se dallon nga fushëveprimi i SNAR 2410?

### **Përgjigje:**

Një rishikim i informacionit financiar të një njësie ekonomike mund të kryhet në përputhje me Standardin Ndërkombëtar mbi Angazhimet të Rishikimit (SNAR) 2400 (i rishikuar), Angazhimet për Rishikimin e Pasqyrave Financiare, ose SNAR 2410, Rishikimi i Informacionit Financiar të Ndërmjetëm të Kryer nga Audituesit e Pavarur të Entitetit, në përshtatje me rrethanat

Fushëveprimi i SNAR 2400

1. Ky Standard Ndërkombëtar për Angazhimet e Rishikimit (SNAR) trajton:

a) Përgjegjësitë e ortakut të angazhimit kur angazhohet për të kryer një rishikim të pasqyrave financiare historike, kur ortakut i angazhimit nuk është i emëruar si audituesi i pasqyrave financiare të njësisë ekonomike; dhe

b) Formën dhe përmbajtjen e raportit të ortakut të angazhimit mbi pasqyrat financiare në rishikim.

2. Ky SNAR nuk trajton një rishikim të pasqyrave financiare të një njësie ekonomike ose të informacionit financiar të ndërmjetëm, të kryer nga një ortak angazhimi i cili është i emëruar si auditues ligjor i pasqyrave financiare të asaj njësisë ekonomike.

3. Ky SNAR duhet të zbatohet, i përshtatur sipas nevojës, për rishikimet e informacioneve financiare historike të tjera. Angazhimet e sigurisë së kufizuar, përveç rishikimit mbi informacionet financiare historike kryhen sipas SNAS 3000

Fushëveprimi i SNAR 2410

4. Ky Standard Ndërkombëtar për Angazhimet e Rishikimit (SNAR) trajton:

a) Përgjegjësitë e ortakut të angazhimit kur një auditues ligjor ndërmerr një angazhim për të rishikuar informacionin financiar të ndërmjetëm të një klienti auditimi; dhe

b) Formën dhe përmbajtjen e raportit të rishikimit të audituesit ligjor mbi informacionin financiar në rishikim.

**Pyetje 10:** Përkruani se çfare duhet të marri në konsideratë Audituesi kur përcakton natyrën, kohën dhe shtrirja e procedurave të ekzaminimit sipas Standardit Ndërkombëtar për Angazhimet e Dhënies së Sigurisë (SNAS) 3400. “Shqyrtimi i informacioneve financiare të perspektives”.

**Përgjigje:**

Audituesi duhet të marri në konsideratë në përcaktimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes të procedurave të ekzaminimit sipas SNAS 3400 si më poshtë:

a) Gjasat e anomalive materiale;

b) Njohuritë e marra gjatë ndonjë angazhimi të mëparshëm;

c) Kompetencën e Drejtuesve në lidhje me përgatitjen e informacioneve financiare të perspektives;

d) Masën në të cilën informacioni financiar perspektiv ndikohet nga gjykimi i Drejtimit; dhe

e) Përshtatshmëria dhe besueshmëria e të dhënave mbështetese

## USHTRIME (6 pikë secila pyetje)

### Ushtrimi 1

Një firmë auditimi në Shqipëri, XYZ Auditim, ka shkelur rregullat kryesore që kërkojnë që shumica e anëtarëve të drejtimit të jenë auditues ligjorë të licensuar. BMP i ka dhënë firmës një afat për të korrigjuar këtë problem. Firma XYZ Auditim nuk ka bërë asnjë ndryshim deri në fund të afatit.

#### **Kerkohet:**

Cilat veprime mund të ndërmarrë Bordi kundër XYZ Auditim? Cilat janë pasojat e mundshme për regjistrimin e firmës dhe aftësinë e saj për të operuar si firmë audituese ligjore?

#### **Përgjigje:**

Disa nga kushtet që Komiteti i Regjistrimit regjistron një shoqëri audituese për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare, që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, janë:

- shumica e të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë zotërohen nga shoqëri audituese, vendase ose të huaja, ose nga auditues ligjorë;
- shumica deri në maksimumin 75 për qind e anëtarëve të organit drejtues ose administrativ të shoqërisë audituese janë auditues ligjorë, vendas ose të huaj, të njohur nga Komiteti i Regjistrimit dhe të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë. Kur organi drejtues ose administrativ nuk ka më shumë se dy anëtarë, të paktën njëri prej këtyre anëtarëve duhet të plotësojë kushtet e përmendura në këtë shkronjë;
- shoqëria angazhon auditues ligjorë, vendas ose të huaj, të cilët janë të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë etj.

Për këtë arsye, qartësisht shoqëria XYZ është në shkelje të kërkesat ligjore të nenit 21 të ligjit të auditimit. Bordi, në vend të heqjes së të drejtës për ushtrimin e veprimtarisë, mund të përcaktojë një kohë të arsyeshme, për të rregulluar gjendjen e pjesëmarrjes në kapital apo të pjesëmarrjes në organet drejtuese. Nëse edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar nga bordi, gjendja nuk është rregulluar, bordi vendos heqjen e së drejtës për ushtrimin e profesionit dhe çregjistrimin nga regjistri publik. Kjo periudhë pezullimi mund të shoqërohet edhe me penalitete financiare si masa shtrënguese për shkak të mosplotësimit të kërkesave ligjore. E drejta për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri audituese hiqet nga bordi, në rastet kur shkelen kushtet dhe/ose kur ndryshojnë rrethanat e parashikuara në këtë ligj, të cilat konsiderohen të domosdoshme për autorizimin e regjistrimit. Kjo përbën edhe një nga kushtet e nenit 26 për çregjistrimin përfundimtar ç) është hequr e drejta e ushtrimit të profesionit, për shkak të ndryshimit të kushteve të domosdoshme për regjistrim, të lidhura me pjesëmarrjen në kapital.

## Ushtrimi 2

Shoqeria e auditimit "Audit Shpk" është e angazhuar për të audituar pasqyrat financiare të një shoqërie transporti. Si pjesë e angazhimit, ekipi i auditimit është përgjegjës për vlerësimin dhe testimin e kontrolleve të brendshme të shoqërisë së transportit. I njëjti ekip që teston kontrollet e brendshme ndihmon gjithashtu klientin në hartimin dhe zbatimin e procedurave të reja të kontrollit në fillim të periudhës raportuese financiare për të cilën do të lëshohet edhe opioni i adutiesit.

### **Kërkohet:**

Te vlerësohet se cilat janë procedurat që Audit Shpk duhet të marrë parasysh në vazhdimin e angazhimit si dhe nëse do duhet të ketë masa të vendosura për adresuar kërkesimet e vetë-rishikimit ose të konfliktit të interesit?

### **Përgjigje:**

Audit shpk duhet të sigurohet që personel i ndryshëm të caktohet për të hartuar dhe zbatuar procedurat e kontrollit kundrejt atyre që janë caktuar për t'i testuar dhe vlerësuar ato. Për shembull, ekipi i auditimit përgjegjës për vlerësimin e efektivitetit të kontrolleve do të jetë i ndryshëm nga ekipi që fillimisht asistojnë klientin të hartojë dhe zbatojë ato kontrolle. Audit Shpk organizon një rishikim të pavarur të kontrollit të cilësisë ku një auditor me përvojë ose një specialist nga një departament tjetër, i cili nuk ishte i përfshirë në hartimin ose zbatimin e kontrolleve, kryen një rishikim të veçantë të procedurave dhe rezultateve të testimit të kontrollit të ekipit të auditimit. Ky rishikues i pavarur vlerëson nëse kontrollet janë vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Duke ndarë detyrat dhe duke përdorur një rishikues të pavarur, shoqëria e auditimit siguron që vlerësimi i kontrolleve të brendshme është i paanshëm dhe se objektiviteti i ekipit të auditimit ruhet. Kjo mbrojtje ndihmon në adresimin e kërkesimit të vetë-rishikimit dhe ruan cilësinë dhe integritetin e auditimit.

## Ushtrimi 3

Një kompani e listuar në bursë ka kërkuar shërbime nga një auditues i jashtëm për të kryer auditimin e saj vjetor. Gjatë bisedimeve fillestare për nënshkrimin e kontratës së auditimit, menaxhimi i kompanisë i kërkon audituesit të ofrojë shërbime shtesë, përfshirë konsulencën mbi strategjinë financiare të kompanisë. Menaxhimi argumenton se ekspertiza e audituesit do të ishte e vlefshme për të optimizuar politikat financiare të kompanisë, duke përfshirë vendime mbi investimet dhe strukturën e kapitalit.

### **Kërkohet:**

A duhet audituesi të pranojë kërkesën për të ofruar këto shërbime shtesë? Çfarë thotë SNA 210 mbi përcaktimin e kushteve të angazhimit dhe si duhet të veproni audituesi në këtë situatë?

### **Përgjigje:**

Ofrimi i konsulencës mbi strategjinë financiare do të përbënte një konflikt të interesit, pasi audituesi do të shqyrtonte politikat financiare që ai vetë mund të ketë ndikuar, duke rrezikuar objektivitetin dhe integritetin e procesit të auditimit. Sipas SNA 210 "Përcaktimi i Kushteve të Angazhimit të Auditimit", audituesi duhet të qartësojë dhe të dokumentojë kushtet e angazhimit



për të siguruar një ndarje të qartë midis detyrave të auditimit dhe shërbimeve të tjera. Një përfshirje në shërbime që nuk lidhen drejtpërdrejt me auditimin do të minonte pavarësinë e tij. Standardi thekson gjithashtu se audituesi nuk duhet të pranojë detyra që mund të krijojnë ndërlikime të tilla. Nëse ka kërkesa për shërbime shtesë që krijojnë konflikt interesi, audituesi mund të refuzojë nënshkrimin e letrës së angazhimit ose mund të sigurojë që shërbimet e jo auditimit të jenë në përputhje me rregullat e pavarësisë. Në veçanti, për kompanitë e listuara, ndalohen shërbimet e jo auditimit nga audituesi ligjor që lidhen me vendimet për investime dhe strukturën e kapitalit, këshillim mbi financimin e kompanisë, apo këshillim mbi strategjinë financiare.

Audituesi duhet të refuzojë ofertën për të ofruar konsulencë në strategjinë financiare dhe të sqarojë rolin e tij të kufizuar në sigurimin e auditimit të pasqyrave financiare. Ai duhet të referohet në Kodin e Etikës të IFAC apo IEKA dhe të SNA-ve për të mbrojtur pavarësinë profesionale dhe për të shmangur çdo keqkuptim në dukje apo cënim real të pavarësisë dhe objektivitetit të tij.

Audituesi bie dakord për kushtet e angazhimit të auditimit me drejtimin apo me personat e ngarkuar me qeverisjen. Kushtet e rëna dakord të angazhimit të auditimit regjistrohen në një letër angazhimi auditimi, apo forma të tjera marrëveshjeje të përshtatshme të shkruara, dhe përfshijnë:

- (a) Objektivin dhe qëllimin e auditimit të pasqyrave financiare;
- (b) Përgjegjësitë e audituesit;
- (c) Përgjegjësitë e drejtimin;
- (d) Identifikimin e kuadrit të raportimit financiar të përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare,
- (e) Referenca për formën dhe përmbajtjen e pritshme të çdo raporti që do të lëshohet nga audituesi;
- (f) Një pasqyrë që mund të ketë rrethana në të cilat një raport mund të ndryshojë nga forma dhe përmbajtja e tij e pritshme.

#### Ushtrimi 4

Kompania **Electronic Distribution** përdor një organizatë shërbimi të quajtur **DataServis** për përpunimin e të dhënave financiare dhe të faturave për klientët e saj. **DataServis** merret me krijimin dhe shpërndarjen e faturave, si dhe me regjistrimin e pagesave të klientëve në sistemin e kompanisë. Audituesi ka përgjegjësi për të vlerësuar nëse kontrollet e brendshme të implementuara nga **DataServis** janë të përshtatshme për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave financiare të **Electronic Distribution**.

#### Kërkohet:

Shpjegoni se cilat janë konsideratat kryesore që duhet të marrë parasysh audituesi për të vlerësuar rreziqet e anomalive materiale në lidhje me përdorimin e organizatës së shërbimit **DataServis**, dhe përshkruani procedurat e duhura të auditimit për këtë rast.

#### Përgjigje:

Konsideratat Kryesore:

- **Kontrolli i Brendshëm i DataServis:** Audituesi duhet të shqyrtojë dhe të vlerësojë kontrollet e brendshme të implementuara nga DataServis, duke analizuar nëse ato janë të projektuara për të parandaluar ose zbuluar anomalitë materiale në të dhënat financiare.

- **Vlerësimi i Rrezikut të Anomalive:** Audituesi duhet të identifikojë dhe të vlerësojë rrezikun e anomalive materiale që mund të ndodhin nga dështimi i kontrolleve të brendshme ose nga gabimet në procesin e përpunimit të të dhënave.
- **Natyrën e Shërbimeve të Ofruara:** Audituesi duhet të marrë parasysh natyrën e shërbimeve që DataServis ofron, si krijimi dhe shpërndarja e faturave dhe regjistrimi i pagesave, për të kuptuar potencialin e rrezikut në secilën fazë të procesit.
- **Monitorimi dhe Rishikimi:** Audituesi duhet të shqyrtojë nëse Electronic Distribution ka vendosur mekanizma të mjaftueshëm për monitorimin dhe rishikimin e performancës së DataServis, për të siguruar që kontrollet e brendshme janë duke funksionuar siç është planifikuar.

#### Procedurat e Auditimit:

- **Rishikimi i Dokumentacionit të Kontrollit:** Audituesi duhet të rishikojë dokumentacionin që përshkruan kontrollet e brendshme të DataServis, duke përfshirë politikat dhe procedurat për përpunimin e faturave dhe regjistrimin e pagesave.
- **Testimi i Kontrollit:** Audituesi duhet të kryejë teste për të vlerësuar efektivitetin e kontrolleve të brendshme, duke përfshirë testimin e rasteve të caktuara të faturave dhe pagesave për të konfirmuar se ato janë regjistruar saktë.
- **Analiza e Transaksioneve:** Audituesi duhet të analizojë një mostrë transaksionesh që janë përpunuar nga DataServis për të identifikuar ndonjë gabim ose anomali të mundshme që mund të ndikojnë në saktësinë e pasqyrave financiare.
- **Intervistat me Stafin:** Audituesi duhet të intervistojë stafin e Electronic Distribution dhe DataServis për të kuptuar më mirë proceset dhe për të identifikuar çdo problem të mundshëm në zbatimin e kontrolleve.
- **Vlerësimi i Mangësive:** Audituesi duhet të identifikojë dhe vlerësojë ndikimin e çdo mangësie në kontrollet e DataServis mbi pasqyrat financiare të Electronic Distribution.
- **Dokumentimi i Gjetjeve:** Audituesi duhet të dokumentojë gjetjet e tij në lidhje me efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe rreziqet e mundshme, si dhe të ofrojë rekomandime për përmirësimin e procedurave.

Këto konsiderata dhe procedura do të ndihmojnë audituesin të sigurojë që të dhënat financiare të Electronic Distribution janë të sakta dhe të besueshme, duke adresuar rreziqet e mundshme të anomalive materiale që lidhen me përdorimin e DataServis.

## Ushtrimi 5

Gjatë auditimit të kompanisë “Tech Logistics”, audituesi zbulon se kompania ka shkelur disa dispozita të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Tatimore (Ligji Nr. 9920), specifikisht në raportimin e të ardhurave dhe pagesat e TVSH-së. Kompania ka fshehur të ardhura nga disa kontrata të rëndësishme dhe nuk ka paguar TVSH-në për transaksione të cilat ligjërisht kërkojnë tatimin e tyre. Si rezultat, kompania ka shmangur detyrime tatimore në shumën prej 500,000 EUR. Këto shkelje janë kryer për një periudhë prej 2 vitesh dhe nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare të kompanisë.

### Kërkohet:

Si duhet të veprojë audituesi sipas ISA 250 dhe çfarë ndikimi kanë këto shkelje në opinionin e auditimit?

### Përgjigje:

Gjatë auditimit të kompanisë "Tech Logistics", në rastin papjtueshmërisë me ligjin e administratës tatimore dhe procedurave tatimore, audituesi duhet të veprojë sipas parimeve dhe udhëzimeve të përcaktuara në Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (ISA) 250, i cili trajton “Marrëdhëniet me Ligjin dhe Rregullat e Tjera”. Ja se si duhet të veprojë audituesi dhe çfarë ndikimi kanë këto shkelje në opinionin e auditimit:

1. **Identifikimi i Papajtueshmërive:** Audituesi duhet të dokumentojë shkeljet e ligjit të zbuluara, duke përfshirë informacionin e nevojshëm rreth natyrës dhe ndikimit të tyre në pasqyrat financiare.
2. **Vlerësimi i Ndikimit:** Audituesi duhet të vlerësojë nëse shkeljet e ligjit, si shmangia e detyrimeve tatimore, kanë ndikim të rëndësishëm në saktësinë e pasqyrave financiare. Në këtë rast, 500,000 EUR të shmangura në detyrimet tatimore duke konsideruar materialitetin mund përbëjnë një shumë materiale, për të ndikuar në opinionin e auditimit.
3. **Konsultimi me Menaxhimin:** Audituesi duhet të diskutojë gjetjet e tij me menaxhimin e kompanisë, duke i kërkuar një shpjegim për shkeljet dhe veprimet e ndërmarra për të adresuar këto probleme.
4. **Raportimi i Shkeljeve:** Nëse menaxhimi nuk merr masa për të korrigjuar shkeljet e zbuluara, audituesi duhet të shqyrtojë nevojën për të informuar organet e jashtme të rregullimit, siç janë autoritetet tatimore

### Ndikimi në Opinionin e Auditimit:

- Nëse audituesi arrin në përfundimin që papajtueshmëria e identifikuar ka një efekt material në pasqyrat financiare dhe ajo nuk është reflektuar në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare, ai duhet të shprehë një opinion me rezervë ose një opinion kundër mbi pasqyrat financiare.

Në përfundim, audituesi ka detyrimin të veprojë në përputhje me ISA 250 për të siguruar që pasqyrat financiare të reflektojnë saktësisht situatën financiare të kompanisë dhe të informojë për çdo shkelje të rëndësishme që ndikon në opinionin e tij.

## Ushtrimi 6

Shoqëria “AIR” ka blerë gjatë vitit 2023 rreth 50 mijë hektar tokë pranë aeroportit kryesor të qytetit me një kosto rreth LEK 300 milion. Prona është e vlerësuar si aktiv afatgjat material në pasqyrat financiare dhe shoqëria planifikon ta shesë më një vlerë të drejtë LEK 350 milion, duke njohur kështu menjëherë një fitim

prej LEK 50 milion. Ortaku i auditimit ka kërkuar angazhimin e një vlerësuesi të jashtëm për verifikimin e vlerës së drejtë të pronës.

#### **Kërkohe:**

- a. Shpjegoni elementët që duhen konsideruar gjatë vlerësimit të punës së një eksperti të jashtëm.
- b. A duhet të dokumentoni punën e ekspertit të drejtimit lidhur me vlerësimin e vlerës së drejtë prej LEK 350 milion?

#### **Përgjigje:**

##### **a) Elementët që duhen konsideruar gjatë vlerësimit të punës së një eksperti të jashtëm**

Kur audituesi angazhon një ekspert të jashtëm për të verifikuar vlerën e drejtë të pronës, duhet të marrë parasysh disa elementë për të vlerësuar dhe besuar punën e këtij eksperti, sipas SNA 500 – Evidencat e Auditimit, si më poshtë:

- Aftësitë dhe Kompetencat e Ekspertit: Audituesi duhet të shqyrtojë kualifikimet profesionale të ekspertit, përfshirë certifikatat, licencat dhe përvojën e tij në vlerësimin e pronave të ngjashme. Është e rëndësishme të sigurohet që eksperti ka njohuritë dhe përvojën e duhur për të kryer një vlerësim të saktë.
- Objektiviteti dhe Pavarësia e Ekspertit: Audituesi duhet të vlerësojë nëse eksperti është i pavarur nga shoqëria që auditon dhe nëse ai mund të kryejë punën në mënyrë objektive, pa ndonjë konflikt interesi.
- Niveli i kompleksitetit – audituesi duhet të vlerësojë natyrën dhe kompleksitetin e procedurës së auditimit dhe për këtë duhet të jetë në gjendje të vlerësojë supozimet/metodologjinë e përdorur nga eksperti për vlerësimin.

##### **b) Audituesi duhet të dokumentojë punën e ekspertit në lidhje me vlerësimin e vlerës së drejtë prej LEK 350 milion për disa arsye:**

- Përputhshmëria me standardet e auditimit: SNA 500 kërkon që audituesi të mbledhë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur konkluzionet e tij. Kjo përfshin dokumentimin e punës së ekspertëve të jashtëm për të mbështetur rezultatet e auditimit. Mbi të gjitha audituesi duhet të analizojë konkluzionet e nxjerra nga eksperti i jashtëm dhe supozimet e ngritura prej tij gjatë vlerësimit.
- Justifikimi i opinionit të auditimit: Dokumentimi i analizës së ekspertit dhe mënyrës se si ai ka arritur në vlerësimin e vlerës së drejtë prej LEK 350 milion është thelbësor për të mbështetur opinionin e auditimit dhe për të siguruar që nuk ka pasur ndonjë mbivlerësim të pronës.
- Rishikimi dhe Vlerësimi i Punës së Ekspertit: Duke dokumentuar procesin dhe rezultatet e ekspertit, audituesi siguron që puna e tij është e verifikuar dhe mund të rishikohet në rast të ndonjë dyshimi ose rishikimi të mëvonshëm.

## Ushtrimi 7

Shoqëria “KROM” është në fazë likuidimi dhe ju jeni angazhuar si auditues ligjor për periudhën deri në mbylljen e subjektit. Aktualisht jeni duke testuar balancat e cash-it dhe keni evidentuar në librat kontabël rreth 1000 lëvizje cash, nga të cilat 400 janë mbi nivelin maksimal të kërkesës për miratim nga CEO. Për 200 nga këto lëvizje keni kërkuar evidencat përkatëse për të verifikuar existencën, plotësinë dhe saktësinë e pagesës.

### Kërkohet:

- a. Shpjegoni natyrën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit që do të përdornit në këtë rast.
- b. Cilësoni elementët kryesorë që duhet të përmbajnë evidencat e auditimit lidhur me 200 lëvizjet cash të përzgjedhura?

### Përgjigje:

a) Në auditimin e lëvizjeve të cash-it për shoqërinë "KROM", natyra dhe shtrirja e procedurave do të përfshijnë kontrollin e evidencave të brendshme dhe të jashtme për të siguruar që lëvizjet të janë të sakta dhe të plota. Procedurat kryesore do të përfshijnë:

- Inspektimi i politikave dhe procedurave në fuqi për transaksionet me cash dhe nivelet e aprovimit nga CEO dhe personel tjetër përgjegjës. Cdo dokument duhet të jetë i nënshkruar dhe personeli duhet të jetë në dijeni dhe t'i kuptojë këto procedura.
- Kryerja e testeve të kontrollit për lëvizjet cash sipas frekuencave të kontrolleve që kryhen mbi nivelet e aprovimit të këtyre transaksioneve dhe cdo formë rakordimi që kryhet mbi lëvizjet cash. Ky testim përfshin inspektimin e procedurave, kryerjen e intervistave me personelin përgjegjës dhe drejtimin e shoqërisë, observimin e proceseve të punës të lidhura me këtë kontroll, inspektimin e dokumentacionit të kërkuar për transaksionet sipas frekuencës së kontrollit.
- Kryerja e testeve në detaje për 200 transaksionet e kërkuara duke inspektuar faturat, mandat pagesën cash, kontrata, raporte të brendshme, raporte/memo miratimi/ emails etj, konfirmime nga palë të treta. Ky testim jep siguri të arsyeshme për 50% të popullatës së transaksioneve që tejkalojnë limitin e aprovimit nga CEO.
- Projektioni në popullatë - nëse gjatë testeve të kontrolleve vihen re që kontrollet nuk kanë operuar në mënyrë efektive si dhe nga testet në detaje konkudohet që ka mungesë dokumentacioni apo ka gabime që tejkalojnë një minimum gabimi të pranuar, audituesi mund të projektojë gabimet e evidentuara në popullatën e mbetur 200 raste.
- Kryerja e testeve të kontrolleve dhe thelbësore për pjesën e mbetur të popullatës 600 raste, të cilat janë nën nivelin e aprovimit, për të cilat do të inspektohen faturat, mandat pagesën cash, kontrata, raporte të brendshme, raporte/memo miratimi/ emails etj, konfirmime nga palë të treta. Në varësi të natyrës së lëvizjeve cash (qëllimit të transaksionit) kjo popullatë mund të ndahet në popullata më të vogla nga të cilat të bëhen përzgjedhje të vecanta, ose mund të bëhet një përzgjedhje e cila konsiderohet përfaqësuese për popullatën në tërësi.
- Analiza e transaksioneve të pazakonta: Nësë gjatë testeve më sipër vihen re transaksione të pazakonta, psh. që nuk lidhen me aktivitetin kryesor të biznesit, testimit i këtyre transaksioneve

mund të dokumentohet në një letër pune të vecantë ku fokusi të jetë marrdhënia me palën e tretë. Hulumtime të mëtejshme mund të kryhen me drejtimin e shoqërisë, mbi palën e tretë për ekzistencën e tij dhe llojin e marrdhënies së biznesit.

#### **b. Elementët kryesorë që duhet të përmbajnë evidencat e auditimit lidhur me 200 lëvizjet cash të përzgjedhura**

Për të siguruar që evidencat e auditimit për 200 lëvizjet cash të përzgjedhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, ato duhet të përmbajnë elementët kryesorë si më poshtë:

- **Dokumentacion mbështetës:** Evidencat duhet të përfshijnë faturat ose dokumente të tjera mbështetëse që tregojnë arsyen dhe përfituesin e transaksionit. Këto dokumente duhet të jenë të datuara dhe të përfshijnë detaje të plota për transaksionin.
- **Miratime dhe autorizime:** Dokumentet duhet të përmbajnë miratime nga personat e autorizuar për transaksione të tilla. Në këtë rast, duhet të ketë një evidencë për miratimin nga CEO ose ndonjë zyrtar tjetër për pagesat që kalojnë pragun e kërkuar.
- **Përputhja e shumës së paguar:** Evidencat duhet të verifikojnë që shuma e paguar të përputhet me shumën e shënuar në librat kontabël dhe të jetë për një qëllim legjitim të biznesit.
- **Data dhe përshkrimi i transaksionit:** Çdo evidencë duhet të tregojë qartë datën e kryerjes së transaksionit, përshkrimin e shërbimit ose produktit të marrë, si dhe përfituesin.
- **Dëshmi të pagesave:** Dëshmi që pagesat janë kryer realisht, për shembull, duke përfshirë kopje të urdhrave të transferit, tërheqjeve nga llogaritë bankare, ose firmat e marra për pagesat cash.
- **Shpjegimi për pagesat e pazakonta:** Për pagesat që duken të pazakonta për nga shuma ose qëllimi, duhet të përfshihen shpjegime të qarta dhe të dokumentuara që justifikojnë këto lëvizje.